

Hapja e garës për hetuesit e BKH-së, SHBA ftesë për të aplikuar

Hapja e garës së Byrosë Kombëtare të Hetimit për përzgjedhjen e 60 hetuesve specialë, ka sjellë përshëndetjen dhe SHBA-së duke u shprehur se “Shqipëri meriton një drejtësi transparente dhe profesionale”.

SHBA njofton se këta hetues special do të kenë trajnime dhe specializime, ndërsa do të kalojnë mjaft teste për pastërtinë e figurës së tyre, pasi do të luajnë një rol kyç në dhënien e drejtësisë në emër të shqiptarëve.

SHBA fton të gjithë ata persona që plotësojnë kushtet që të bëhen pjesë e aplikimeve dhe të ndihmojnë në krijimin e një sistemi drejtësisë etike.

“Shtetet e Bashkuara janë të angazhuara në mbështetjen e përpjekjeve të Shqipërisë në krijimin e një sistemi drejtësie etik, transparent dhe profesional, siç e meritojnë shqiptarët.

Je pjesë e elitës që do ndihmojë në krijimin e një Shqipërie më të mirë?

Hetuesit e BKH-së do të jenë ndër pjesëtarët më të mirëtrajnuar dhe më të vetuar të organeve ligjzbatuese në vend dhe do të luajnë një rol kyç në dhënien e drejtësisë në emër të shqiptarëve’, shkruan ambasada e SHBA-së.